

VENDIM
Nr.252, datë 12.3.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË BELSH, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Belsh, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Belsh, të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.19, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Belsh, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe bashkia Belsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Belsh

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
5	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
6-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
18,19	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
21-53	Varrezat publike	Në pronësi
54-150	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
151-291 (vetëm trojet)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
151-291 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
292-306	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi

307-309, 315,323,324, 340,341,343,344,345,347,35 0,351,352,357,358,362,363,3 65,368,369,371,374, 375,379,380,387	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
311,312,316,317,318,326,32 8,329,348,349,354,355,356,3 60,361,366,367,372, 373,377,378,383,384,385,38 6,389,390,391,392,393,394- 672 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
676 - 1236	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi